

Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
Kancelarija Specijalnog Tužilaštva Republike Kosovo

Prishtinë, 29 Nëntor 2012

GJPP 97/2012

PPS 89/2012

Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë

Në përputhje me Nenet 304(1), 305 dhe 306 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK),
Prokurori i nënshkruar më poshtë paraqet këtë:

AKTAKUZË E NDRYSHUAR

Në përputhje Vendimin e Gjykatësit për konfirmim të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, të datës
26 Nëntor 2012, ndaj të pandehurit të mëposhtëm:

1.

Emri	Jovica DEJANOVIĆ
Pseudonimi	“Pero”
Emri i babait	██████
Datëlindja	11.09.1954
Shtetësia	Kosovë
Kombësia	Serb
Gjinia	mashkull
Vendlindja	Gllavotinë
Vendbanimi	Priluzhjie

Që akuzohet për veprat e mëposhtme penale:

1) **Krime lufte kundër popullatës civile**, që përkufizohet dhe dënohet me Nenet **22 dhe 142 të Kodit Penal te Republikës Socialiste Federative te Jugosllavisë (KPRSFJ)** që tani është e paraparë si vepër penale në Nenin 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sepse në shkelje të **Nenit 3 të përbashkët** me katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, dhe **Neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit II** të datës 8 Qershor 1977, shtesë në Konventat e Gjenevës 1949, si dhe të gjitha rregullave dhe ligjeve ndërkombëtare që ishin në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë Aktakuzë, i **pandehuri**, në cilësinë e pjesëtarit të Policisë Serbe apo formacioneve paramilitare Serbe, ka **përdhunuar** V. K., një femër civile shqiptare e Kosovës; më saktësisht, i pandehuri, që ka qënë i armatosur me një pushkë, e ka transportuar me makinë viktimën deri tek një vendndodhje e panjohur pranë Babin Mostit dhe aty e ka detyruar atë me forcë, duke e kërcënuar atë me thikë, që të kryente tipe të ndryshme marëdhëniesh seksuale kundër vullnetit të saj brenda në makinën e tij;

- Në Babin Most (Komuna e Obiliqit) më 14 Prill 1999.

1) **Pronësi, kontroll, zotërim dhe përdorim i pa-autorizuar i armëve**, që parashikohet dhe ndëshkohet sipas Nenit 328 të Kodit Penal të Kosovës, sepse i pandehuri është gjetur në zotërim të paligjshëm të 9 fishekëve të kalibrit 9 mm, gjatë kontrollit të shtëpisë së tij, pa pasur një leje për mbajtjen e armës;

- Në Priluzhje (Komuna e Vushtrrisë), më 27 Shtator 2012.

2.

Emri dhe mbiemri	Djordje BOJKOVIĆ
Pseudonimi	“Djoko”
Emri i babait	██████████
Datëlindja	13.11.1940
Shtetësia	Kosovë
Kombësia	Serb
Gjinia	Mashkull
Vendlindja	Babin Most
Vendbanimi	Babin Most

Që akuzohet për veprat e mëposhtme penale:

1) Krime lufte kundër popullatës civile, që përkufizohet dhe dënohet me Nenet **22 dhe 142 të Kodit Penal te Republikës Socialiste Federative te Jugosllavisë (KPRSFJ)** që tani është e paraparë si vepër penale në Nenin 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sepse në shkelje të **Nenit 3 të përbashkët** me katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, dhe **Neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit II** të datës 8 Qershor 1977, shtesë në Konventat e Gjenevës 1949, si dhe të gjitha rregullave dhe ligjeve ndërkombëtare që ishin në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë Aktakuzë, i **pandehuri**, ka **përdhunuar** V■■■■ K■■■■, një femër civile shqiptare e Kosovës, që ishte rrëmbyer nga oficeri i policisë Serbe, Jovica Dejanović; më saktësisht, i pandehuri që kishte një armë me vehte, e ka sjellë viktimën deri tek një shtëpi e pambaruar në Babin Most, aty e ka hedhur atë në dysheme dhe e ka detyruar që të kryente marrëdhënie seksuale kundër vullnetit të saj.

- **Në Babin Most (Komuna e Obiliqit) më 14 Prill 1999.**

2) Pronësi, kontroll, zotërim dhe përdorim i pa-autorizuar i armëve, që parashikohet dhe ndëshkohet sipas Nenit 328 të Kodit Penal të Kosovës, sepse i pandehuri është gjetur në zotërim të paligjshëm të një automatiku AK-47, tre karikatorëve dhe 69 fishekëve, pa pasur një leje për mbajtjen e armës.

- **Në Babin Most (Komuna e Obiliqit), më 27 Shtator 2012.**

ARSYETIMI

Dyshimi i bazuar ndaj këtyre të pandehurve mbështetet kryesisht në deklaratat e dhëna nga viktima V■■■■ K■■■■, në datat 13.10.1999, 24.8.2010, 30.12.2010 dhe 17.7.2012.

Ne veçanti, Znj. K■■■■ ka deklaruar se më 14 Prill 1999, rreth orës 19:30 min, një officer i policisë Serbe kishte shkuar tek shtëpia e familjes K■■■■ në Stanovc. Kur ishte pyetur specifikisht nëse ajo e kishte parë të njëjtin oficer policie edhe më parë, ajo kishte deklaruar se polici në fjalë kishte qënë tek shtëpia e tyre një ditë më herët, siç ka deklaruar edhe vëllai i saj, N■■■■ K■■■■ (deklarata e datës 21.3.2012). Pjesëtarët e tjerë të familjes së saj, duke përfshirë nënën e viktimës H■■■■, kanë pohuar se në atë periudhë policia Serbe vinte shpesh tek shtëpia e familjes K■■■■.

Sipas viktimës dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes që kishin qënë dëshmitarë të ngjarjes (duke përfshirë H■■■■ K■■■■, M■■■■ K■■■■, ■■■■■ G■■■■, M■■■■ K■■■■), oficeri i policisë Serbe mbante të veshur një uniformë dhe kishte një armë automatike. Oficeri i kishte

thënë viktimës se ajo duhej të shkonte me të deri tek një fshat aty afër i quajtur Priluzhje, ku ajo do të merrej në pyetje.

Polici Serb e kishte marrë Znj. K. nga shtëpia e saj dhe e kishte futur në një makinë Zastava 101; më pas ai e kishte sjellë atë me makinë në fshatin e banuar nga serbët të Babin Most-it. Aty makinën e kishin rrethuar disa persona dhe polici ua kishte treguar atyre me krenari Znj. K.

Pak kohë pas kësaj, polici e kishte sjellë me makinë viktimën deri tek një shtëpi aty afër, e kishte parkuar makinën aty dhe e kishte përdhunuar atë nën kërcënimin e armës brenda në makinë.

Pas kësaj, polici e kishte sjellë viktimën me makinë deri tek një dyqan pijesh në Babin Most. Pasi ai kishte dalë nga makina dhe kishte hyrë në dyqan, një burrë tjetër kishte dalë nga dyqani, kishte hyrë në makinë dhe e kishte vozitur viktimën deri tek një përrua. Viktima kishte filluar të bërtiste dhe ai burri e kishte kthyer atë sërish me makinë deri tek dyqani i pijsve.

Në këtë pikë, një burrë i tretë më i vjetër në moshë kishte hyrë në makinë dhe e kishte ngarë makinën me viktimën duke u larguar. Ai e kishte sjellë atë me makinë deri tek një shtëpi aty afër dhe aty e kishte përdhunuar.

Pas kësaj, oficeri i policisë serbe dhe ai burri më i vjetër e kishin kthyer viktimën me makinë përsëri në fshatin e saj, duke e kërcënuar atë që të mos i tregonte askujt për atë çfarë kishte ndodhur.

Ditën tjetër pas kësaj, viktima i kishte raportuar Policisë Ushtarake të UÇK-së për çka i kishte ndodhur. Kur ishte intervistuar si dëshmitar, oficeri i Policisë Ushtarake, Sh. K., kishte deklaruar se atij i kujtohej se si V. K. kishte ardhur në zyrën e tij dhe i kishte raportuar se një ditë më herët atë e kishin përdhunuar dy burra serbë.

Përgjegjësia individuale e Jovica DEJANOVIĆ

Viktima e kishte përshkruar oficerin e policisë Serbe, që e kishte rrëmbyer atë nga shtëpia e saj e më pas e kishte përdhunuar, si një person shtatgjatë e të hollë me flokë të shkurtra të zeza dhe me sy ngjyrë të gjelbërt/kafe. Një përshkrim të ngjashëm kishin dhënë edhe pjesëtarët e tjerë të familjes K., që kishin parë rrëmbimin e Znj. K.

Znj. K. kishte identifikuar Jovica Dejanović në një demonstrim fotografish si oficerin e policisë Serbe që e kishte rrëmbyer dhe përdhunuar atë më 14 Prill 1999. Të dhënat e tjera që

konfirmojnë se viktimja ka indentifikuar saktësisht Zt. Dejanović, si personin që e kishte përdhunuar atë, janë si vijon:

1. Viktimja kishte deklaruar se ajo ishte rrëmbyer nga një oficer i armatosur i policisë Serbe: Zt. Dejanović ka pohuar se në Prill 1999 ai kishte shërbyer si oficer policie në rezervë, se i ishte dhënë një uniform policie dhe një armë gjysmë-automatike, dhe se ai ishte stacionuar në pikën e kontrollit afër Vushtrrisë përgjatë gjithë kohës së luftës.

2. Viktimja kishte deklaruar se polici Serb e kishte futur dhe vozitur atë tutje me një makinë Zastava 101. Zt. Dejanović ka pohuar se në vitin 1999 ai zotëronte një makinë Zastava 101.

3. Viktimja më tej ka deklaruar se polici Serb kishte një fashim përreth njërit prej krahëve të tij. Gjatë hetimit, Zt. Dejanović i është nënshtruar një kontrolli mjekësor, që zbuloi disa shenja të një plage të vjetër në gishtin e madh të dorës së tij të djathtë. Kur ishte marrë në pyetje si i pandehur, Zt. Dejanović kishte pohuar se ai kishte pasur një lëndim në gishtin e madh të dorës dhe kishte shpjeguar se ai lëndim ishte shkaktuar nga një aksident që i kishte ndodhur në vendin e tij të punës përpara luftës.

Identifikimi i bërë nga viktimja përforcohet edhe nga dëshmitë e pjesëtarëve të tjerë të familjes, që kishin qënë të pranishëm në shtëpinë e familjes Krasniqi më 14 Prill 1999, e të cilët kishin indentifikuar gjithashtu Zt. Dejanović si policin që kishte rrëmbyer Znj. K [REDACTED]¹. Në vijim, N [REDACTED] K [REDACTED], vëllai i viktimës, e kishte indentifikuar Zt. Dejanović si policin që kishte ardhur tek shtëpia e familjes K [REDACTED] një ditë përpara rrëmbimit (dhe i cili, sipas viktimës, ishte i njëjti person që më pas e kishte rrëmbyer dhe përdhunuar atë)².

Mbi bazën e identifikimeve të shumta e të sigurta përmes fotografive dhe bazuar në të dhënat e tjera unike personale që janë ofruar (lëndimi në dorë, makina e përdorur etj) nuk ka asnjë dyshim se V [REDACTED] K [REDACTED] ka indentifikuar saktë Zt. Dejanović si policin Serb që e kishte rrëmbyer dhe përdhunuar atë më 14 Prill 1999.

Akuza për armët që buron nga gjetja e nëntë plumbave në vendbanimin e Zt. Dejanović është e provuar mbi bazën e raportit mbi kontrollin që është përgatitur nga Policia e EULEX.

Përgjegjësia individuale e Djordje BOJKOVIĆ

¹ I [REDACTED] G [REDACTED], 26.4.2012; M [REDACTED] K [REDACTED], 26.4.2012; H [REDACTED] K [REDACTED], 24.5.2012.

² N [REDACTED] K [REDACTED] deklarata e datës 16.5.2012.

Znj. K. [REDACTED] ka deklaruar se, pasi ishte përdhunuar nga Jovica Dejanović, ajo ishte përdhunuar gjithashtu edhe nga një burrë më i vjetër në moshë. Ajo e ka deklaruar këtë gjatë intervistimeve të saj përpara policisë dhe ajo i kishte raportuar të njëjtat rrethana edhe vëllait të saj dhe oficerit të Policisë Ushtarake të UÇK-së, Sh. [REDACTED] K. [REDACTED], një ditë pas ngjarjes.

V. [REDACTED] K. [REDACTED] e kishte përshkruar personin e dytë që e kishte përdhunuar atë si një burrë më të vjetër në moshë me një trup të fortë, i gjatë 165-170 cm. Ajo e kishte identifikuar Djordje Bojković, nga një demonstrim fotografish që i ishte paraqitur asaj më 17.07.2012, si personin e dytë që e kishte përdhunuar atë.

Znj. K. [REDACTED] kishte deklaruar gjithashtu se burri më i vjetër në moshë që e kishte përdhunuar atë çalonte pak nga njëra këmbë. Kur ishte dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, Z. [REDACTED] G. [REDACTED], një ish-koleg pune i Zt. Bojković, kishte pohuar se ky i fundit çalonte pak dhe se për këtë arsye dikush e kishte quajtur atë "Qopa" ("çalamani")³. Dëshmitari K. [REDACTED] A. [REDACTED], që më parë kishte punuar me Zt. Bojković, kishte pohuar gjithashtu se ky i fundit kishte një mënyrë të çuditshme të ecuri⁴.

Për më tepër, viktimja u kishte treguar hetuesave nga policia edhe shtëpinë e pa-përfunduar në fshatin Babin Most ku atë e kishin përdhunuar. Pas disa hetimeve të mëtejshme që u bënë pranë Kadastrës së Kosovës doli se shtëpia i përkiste vëllait të Djordje Bojković. Kur ishte intervistuar si i pandehur, Zt. Bojković kishte deklaruar se vëllai i tij kishte nisur ta ndërtonte atë shtëpi qysh përpara luftës, dhe se kur kishte nisur lufta shtëpia tashmë e kishte çatinë por ishte e pambaruar. Edhe sot ajo shtëpi është në të njëjtën gjendje siç ishte edhe gjatë kohës së luftës.

Përfundimisht, për sa i takon rrethanave se si kishte ndodhur përdhunimi në fshatin Babin Most, është me vënd të vërejmë se Zt. Bojković është me të vërtetë nga fshati Babin Most. Edhe pse ky i fundit ka deklaruar se kishte jetuar në Prishtinë në atë kohë, ai ka pranuar se shkonte herë pas here në fshatin Babin Most.

Për sa i takon akuzës që ka lidhje me zotërimin e paligjshëm të armëve, Zt. Bojković e mohon të ketë pasur dijeni mbi armët e gjetura në garazhin pranë shtëpisë së tij, dhe pretendon se ato i kishte vënë aty dikush tjetër. Kur u intervistua si i pandehur, Zt. Bojković sqaroi se:

- vetëm ai dhe gruaja e tij banojnë në atë shtëpi;
- prona e tij është gjithandej e rrethuar me gardh;

³ Z. [REDACTED] G. [REDACTED], deklarata e datës 4.10.2012.

⁴ K. [REDACTED] A. [REDACTED], deklarata e datës 30.10.2012.

-ka vetëm një portë për të hyrë në pronën e tij, e cila mbahet e kyçur gjatë gjithë kohës.

Këto rrethana e bëjnë shumë ta pamundur, nëse jo edhe imagjinare, mundësinë që dikush të ketë hyrë brenda pronës së Zt. Bojković dhe ti ketë vendosur armët në garazhin e tij. Përkundrazi, qasja tashmë e pranuar si ekskluzive që Zt. Bojković ka ndaj pronës së tij ngre dyshimin e bazuar se ai i ka mbajtur me dijeni të plotë armët aty, të cilat më pas u gjetën gjatë kontrollit.

Kompetenca territoriale

Prokurori vëren se vepra penale ka ndodhur në fshatin Babin Most, që i përket Komunës së Obiliqit (dhe jo asaj të Vushtrrisë siç është thënë më herët). Prandaj, Gjykata që ka kompetencën territorial për këtë rast është Gjykata e Qarkut në Prishtinë.

Prandaj, Prokurori i kërkon Gjykatësit/Gjykatëses për konfirmim nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, që në përputhje me Nenin 37 të KPPK, të vetëdeklarohet pa kompetencë territoriale për këtë rast dhe t'ia transferojë dosjen e lëndës Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për konfirmimin e Aktakuzës dhe caktimin e gjyqimit kryesor.

PROPOZIMI PËR GJYKIMIN

Prokurori propozon që të caktohet gjyqimi kryesor për këtë rast dhe ai të mbahet në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Prokurori kërkon që të ftohen personat e mëposhtem për të marrë pjesë në të:

- Prokurori i nënshkruar më poshtë;
- Dy të pandehurit, Jovica Dejanović dhe Djordje Bojković, si dhe avokatët e tyre mbrojtës;
- Pala e lënduar V [REDACTED] K [REDACTED] dhe përfaqësuesi i saj ligjor, nëse caktohet një i tillë.

Prokurori propozon që gjatë gjyqimit kryesor të dëgjohen dëshmitarët e mëposhtëm:

1. Pala e lënduar V [REDACTED] K [REDACTED] të dëgjohej përmes videotransmetimit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes ndihmës juridike ndërkombëtare, gjë për të cilën Prokurori i kërkon Gjykatës që të nisë procedurat e nevojshme.

2. [REDACTED] G [REDACTED], fshati [REDACTED] ([REDACTED]);

3. M [REDACTED] K [REDACTED], fshati [REDACTED] ([REDACTED]);

4. H [REDACTED] K [REDACTED], fshati [REDACTED] ([REDACTED]);

5. N [REDACTED] K [REDACTED], fshati [REDACTED] ([REDACTED]);

6. Z [REDACTED] G [REDACTED], fshati [REDACTED] ([REDACTED]);

7. K [REDACTED] A [REDACTED], fshati [REDACTED] ([REDACTED]).

Prokurori propozon që gjatë gjykimit kryesor të paraqiten dokumentat dhe provat e mëposhtme:

- Raporti mjekësor DFM për Jovica Dejanović;
- Raporti i Policisë së Kosovës mbi vendndodhjen e shtëpisë së Djordje Bojković;
- Raportet mbi kontrollet e kryera në shtëpitë e Jovica Dejanović dhe Djordje Bojković;
- Raportet balistike mbi armët e gjetura në shtëpitë e Jovica Dejanović dhe Djordje Bojković

Prokurori i nënshkruar më poshtë njofton Gjykatën se ai mund të propozojë që të paraqiten edhe prova të tjera nëse kjo do të jetë e nevojshme.

Paraqiti me respekt,

Maurizio Salustro
Prokuror në PSRK

AM/H-453/11/2012